



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË
RINJVE

Nr. 89 prot.
Tiranë, më 13.04. 2022

QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT
DHE LEXIMIT

Nr. 166 prot.
Tiranë, më 13.4. 2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË
RINJVE**

(QPKMR)

DHE

QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

(QKLL)

“Për

**ofrimin e shërbimeve në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritimit të të miturve dhe të
rinjve në konflikt me ligjin”**

Preambul:

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (QKLL), në vijim të quajtura *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut;

Duke marrë në konsideratë politikatat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

Duke synuar implementimin efektiv të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nëpërmjet prezantimit të teknikave restauruese për të rinjtë në konflikt me ligjin, teknika inovative në kontekstin shqiptar;

Duke konsideruar se për të kontribuar në respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht të të miturve dhe të rinjve në konflikt ose në kontakt me ligjin është tepër e domosdoshme;

Duke njohur ekspertizën dhe njohuritë institucionale të Qendrës Kombëtare të Leximit, e cila ka mision ndjekjen dhe zbatimin e projekteve në fushën e librit, sipas programit qeverisës të ministrisë përgjegjëse për librin, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje për të përbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të përmirësimit të drejtësisë penale për të miturit dhe të rinjtë;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Nëni 1
Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritimit të të miturve që vuajnë dënimin në Institutin e të Miturve, Kavajë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", si dhe të vendimit nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve".

Neni 3
Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim mbështetjen e të miturve në konflikt me ligjin nëpërmjet:

- a) Pasurimit me libra të bibliotekës së Institutit të të Miturve, Kavajë, ose të të miturve të tjerë në konflikt me ligjin.
- b) Mbështetjes në funksion të botimeve të ndryshme, si libra dhe/ose revista që Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, synon të botojë, me në fokus të miturit/të rinjtë që janë duke vuajtur dënimin apo kanë përfunduar periudhën e vuajtjes së dënimit së fundmi.
- c) Organizimit të aktiviteteve të përbashkëta të palëve, pranë Institutit të të Miturve, Kavajë, me qëllim zhvillimin e kulturës së leximit për të gjithë të miturit që vuajnë dënimin pranë këtij institucioni.
- d) Evidentimin e të miturve me talent të shkruarit e poezive, etj.

Neni 4
Komunikimi mes Palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe në raste të veçanta edhe në rrugë elektronike.
2. Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e kërkesave të tyre në zbatim të Marrëveshjes.
3. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 5
Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Neni 8
Dispozita të fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 5 të saj.
2. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

PËR
QENDRËN E PARANDALIMIT
TË KRIMEVE TË TË MITURVE
DHE TË RINJVE

DREJTORI
KLAUDIA HASANLLARI



PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË
LIBRIT DHE LEXIMIT

DREJTORI
ALDA BARDHYLI

